

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor® ProSeal W

PËRBËRËS ME BAZË UJI PËR THARJEN DHE IZOLIMIN E DYSHEMEVE PREJ BETONI

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor® ProSeal W është emulsion akrilik me bazë uji dhe 1 përbërës për tharjen, ngurtësimin dhe izolimin e betonit të freskët ose të ngurtësuar.

PËRDORIMET

Sikafloor® ProSeal W duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë. Sikafloor® ProSeal W përdoret për tharjen dhe izolimin optimal të dysHEMEVE dhe strukturave prej betoni.

- Përbërës për tharje në mënyrë që të kufizohet plasaritja sipërfaqësore
- Ofron tharje dhe izolim pas aplikimit të forcuesve të sipërfaqes së dysHEMEVE nga seria Sikafloor®
- Trajtim kundër pluhurit dhe për përmirësimin e rezistencës ndaj abrazionit të sipërfaqeve ekzistuese prej betoni
- I përshtatshëm për aplikime të brendshme dhe të jashtme

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Me bazë uji
- I përshtatshëm për përdorim të brendshëm ku produktet me bazë tretësi nuk mund të aplikohen për shkak të rregulloreve për shëndetin dhe sigurinë
- Ndhmon në kontrollin e pluhurosjes për sipërfaqet e dysHEMEVE prej betoni të reja dhe ekzistuese
- Thahet dhe izolon me efikasitet sipërfaqet prej betoni në një veprim të vetëm dhe ekonomik
- Zverdhje shumë e ulët
- Aplikim i lehtë me spërkatje ose rul

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Emulsion akrilik me bazë uji
Ambalazhi	enë 25 l dhe fuçi 200 l
Paraqitja / Ngjyra	Lëng i bardhë, i tejdukshëm pas tharjes.
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur, të padëmtuar dhe të vulosur, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga ngrirja.
Dendësia	~1.0 kg/l (në +20°C)
Përmbajtja e substancave të ngurta për peshë	~16 %

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	0.1–0.2 l/m ² /shtresë Duhet të zbatohen kërkesat dhe udhëzimet e standardeve përkatëse lokale. Këto vlera janë teorike dhe nuk përfshijnë asnjë material shtesë të kërkuar për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel, firos, etj.		
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max.		
Lagështia relative e ajrit	80 % max.		
Pika e vesës	Kujdes kondensimin! Nënshtresa dhe dyshemeja e patharë duhet të jenë të paktën 3°C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit apo çngjyrosjes mbi sipërfaqen përfundimtare.		
Temperatura e nënshtresës	+10 °C min. / +30 °C max.		
Koha e maturimit	Temperatura e nënshtresës	Qarkullim këmbësorësh	Tharja e plotë
	+10°C	~16 orë	~24 orë
	+20°C	~8 orë	~20 orë
	+30°C	~6 orë	~16 orë
	Kohët e tharjes së plotë jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të nënshtresës dhe mjedisit.		
Koha e pritjes / mbiveshja	Shtresat e mëparshme nuk duhet të jenë të ngjithshme përpara aplikimit të shtresave vijuese.		
	Temperatura e nënshtresës	Koha	
	+10°C	~90 minuta	
	+20°C	~45 minuta	
	+30°C	~40 minuta	
	Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të nënshtresës dhe ambientit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.		

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Beton i freskët

Sipërfaqja nuk duhet të ketë ujëra të rrjedhur dhe duhet të ketë rezistencë të mjaftueshme për të përballuar veprimet e finirimit.

Betoni duhet të përgatitet me teknika të përshtatshme (helikopter, procedura përpunimi mekanik).

Beton i ngurtësuar / i vjetër

Sipërfaqet duhet të jenë të qëndrueshme, me teksturë të hapur, të pastra, pa ngricë, kore çimentoje (qumësht), ujë mbi sipërfaqe, vaj, graso, veshje, grimca të lira dhe ndotje të tjera.

Nënshtresa duhet të përgatitet me teknika të përshtatshme përgatitjeje mekanike si uji me presion të lartë ose pajisje pastrimi me rrymë abrazive.

Pluhuri, materialet e lira dhe të shkrifëta duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë dhe/ose vakuum.

Në rast dyshimi, aplikoni më parë mbi një zonë të vogël për provë.

PËRZIERJA

Sikafloor® ProSeal W është gati për përdorim. Përzieni plotësisht me një mikser elektrik në shpejtësi të ulët (~300 rpm) për 2 minuta përpara përdorimit.

APLIKIMI

Mbi betonin e freskët, aplikoni menjëherë pasi të kenë përfunduar teknikat e finirimit.

Mbi betonin ku është aplikuar më parë forcues i sipërfaqes, aplikoni menjëherë pas përfundimit së bluarjes me helikopter.

Aplikoni një shtresë të vazhdueshme dhe të njëtrajtshme me spërkatje në presion të ulët. Përshtatshmëria e pajisjes së spërkatjes duhet të konfirmohet me testime.

Është gjithashtu i mundur aplikimi me rul.

Për arritjen e estetikës vizuale dhe performancës së lartë, rekomandohet një veshje e dytë.

Prisni derisa veshja e parë të mos jetë e ngjithshme përpara se të aplikoni veshjen e dytë. (lexo: koha e pritjes / veshja).

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar /

tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

MIRËMBAJTJA

PASTRIMI

Për të ruajtur paraqitjen e dyshemesë pas aplikimit, nga Sikafloor® ProSeal W duhet të hiqen menjëherë të gjitha rrjedhjet dhe duhet të pastrohet rregullisht me furça rrotulluese, pajisje industriale pastrimi, pastrues me presion të lartë, teknika larjeje dhe vakuumi, etj. duke përdorur detergjentin dhe dyllin e përshtatshëm.

KUFIZIME

- Në mot të nxehtë (mbi +25°C) Sikafloor® ProSeal W duhet të ruhet në vend të freskët përpara përdorimit.
- Në temperatura të ulëta (nën +10°C) produkti mund të trashet dhe si pasojë spërkatet me vështirësi.
- Mos përdorni spërkatës të cilët janë përdorur më parë për spërkatjen e silikonëve apo disarmantëve.
- Mos përzieni formulime të ndryshme të Sika® apo membranave të tjera për maturim.
- Sigurohuni se pajisja e spërkatjes është pastruar plotësisht përpara përdorimit dhe se janë hequr mbetjet e membranave të mëparshme.
- Sikafloor® ProSeal W duhet të hiqet përpara aplikimit të sistemit për veshjen e dyshemesë.
- Sikafloor® ProSeal W rrit rezistencën ndaj abrazionit krahasuar me betonin C25, por do të degradohet gradualisht dhe do të hiqet nga ekspozimi ndaj kushteve të mjedisit dhe qarkullimi i këmbësorëve.
- Nuk rekomandohet për dysheme betoni ku është aplikuar forcues metalik sipërfaqesh.
- Të mos përdoret për aplikime të jashtme mbi sipërfaqe të bardha dhe joabsorbuese, pasi mund të vërehet një zverdhje e lehtë.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor® ProSeal W

Mars 2019, Botimi 01.01

020815110010000008

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42/CE, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (kategori produkti IIA / i lloji wb) është 140 g/l (Kufizimet 2010) për produktin gati për përdorim.

Përmbajtja maksimale e Sikafloor® ProSeal W është < 140 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikafloorProSealW-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf